



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 14433 Prot

Vlorë, më: 18.09 2024

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

RAJONI 4

Datë 11.09.2024 ora 10:00

**Tema: Konsultimi i Programit të Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Vlorë**

**Baza Ligjore:** Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.13107 datë 21.08.2024.

**Marrin pjesë:**

*Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha, Kryetari i Rajonit 4- Donald Leskaj Drejtori i DFKB-Kozma Mali, anëtar të këshillit bashkiak,, drejtorë të administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media dhe OJF lokale.*

*(Në takim morrën pjesë më shumë se 20 persona, listeprezenca bashkangjitur)*

**Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha:** Përshendetje, të gjithëve! Ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe uroj të jeni mirë me shëndet. Jemi mbledhur për të prezantuar projekt buxhetin afatmesëm të Bashkisë Vlorë 2025-2027 për Rajonin 4.

Ky rajon është përballur me vështirësi në zbatimin e projekti të ujësjellësit për ujin e pijshëm. Bisedova me kompaninë zbatuese. Dakortësuam të testohet dhe të fillojnë shtrimet deri në dhjetor.

Shpresoj të bëhet. Nuk është problem vetëm asfaltimi i rrugëve. Kompania është përgjigjur. Pa u mbaruar projekti nuk mund të shtrohet dhe të rihapen. Këto segmente që janë hapur do testohen brenda dhjetorit. Gjatë verës kemi folur për kanalën, kemi ardhur me mjete të Hidrovori, ka 4 ditë që punohet dhe kemi qënë present. E kemi filluar kanalën nga derdhja dhe vazhdohet me pjesën tjetër dhe do të jetë gjithmonë në vëmendje.

Përsa i përket investimeve të rajonit 4:

Rikonstruksioni në shkollën “15 Tetori”, tualetet e shkollës, ka përfunduar projekti dhe është në fazë tenderimi. Është zgjedhur dhe kompania fituese.

Rikonstruksioni i kopshtit nr.14 pranë shkollës “Ibrahim Kushta” ka përfunduar projekti dhe është në fazë tenderimi. Për 1 javë lidhet kontrata.

Shkolla “Jani Minga” rikonstruksion një pjesë, ka përfunduar projekti dhe është në fazë tenderimi.

Rruga “Gani Bejkosala” ka përfunduar projekti dhe tenderimi dhe pritet të fillojë të punimet. Projekti 170 milion lekë.

Sistemimi i disa akseve në Rajonin 4, janë në fazë tenderimi.

Sistemimi i disa akseve pranë stacionit të trenit kemi bërë kërkesë pranë FSHZH.

Rruga Transballkanike do bëhet me sinjalistikë të përshtatshme 10 milion lekë.

Dhe disa segmente me sinjalistikë dhe kangjella 280 milion lekë

Sistemimi i akseve ka përfunduar projekti dhe investimi.

Akset rrugore dhe rruga deri në Manastirin e Zvërnecit kemi bërë kërkesë pranë FSHZH.

Sipas zonave në disa rajone dhe njësi sipas prioriteteve kemi kërkuar dhe financime.

Parkim përballë me manastirin, ka filluar projekti 200.000 Euro më financimin e Bankës Botërore.

Kemi filluar procedurat e pallatit 1300, i cili është në rrezik shembje, është vonuar edhe për shkak të cmimeve të larta. Për këtë arsye kemi ribërë edhe procesin e tenderimit.

Investim në ndricim në rrugën e Sazanit.

Në çfarë faze jemi sot? Për planifikimin e buxhetit për 2025 keni sygjerime? Na i thoni.

**Qytetar:** Jam banor i lagjes 24 Maj, te pallati i Gorishtit, jemi pa ndricim. Rrugët duhen shtuar se nuk ka fare. S’ka shtylla elektrike. Është e nevojshme, është errësirë.

**Qytetar:** Faleminderit që keni asfaltuar. Kam një lokal me liçencë. Erdhi deputeti dhe ia thamë që duam karrige për pleqtë. Projehti i lulishtes te Pallati i Gorishtit do bëhet edhe me stola. Po ashtu edhe te shkolla 15 Tetori.

**Qytetar:** Kam një problem për ne pensionistët. Kemi patur një lokal që qëndrojmë. Mosha e tretë jemi në rrugë. Nuk kemi një vend, një lulishte.

**Qytetar:** Jam banore e lagjes 24 Maj. Jam agronome. Problem është Hidrovori. Raportime fiktive. Kam shkuar në SPAK. Më thanë sill projektin ta verifikojmë. Rruga 100 milion pa parametra, pa barrier. Përfundoi në 19 qershor vjet, është prishur. Rruga, s'ka vijëzime, s'ka shtylla. Bien fëmijët në kanal. 30 vjet aty. Nuk mblidhen ujrë, mbytemi. Kanali që pastrohet 2-3 vjet pa vënë dorë. Janë bërë raportime fiktive. Përball Dapaj, pa vënë dorë, pa u dezinfektuar. Pa ujë, pa pastrim. Parametrat e rrugës, kolaudimi nga personat përgjegjës.

**Qytetar:** Faleminderit. Të kritikojmë që të punojmë. Kam respekt për ju kryetar. Jemi dëgjuar. Rruga pa shtruar 300 m, Mehmet Halimi. Kanali pa pastruar. Duam lulishte.

**Ermal Dredha:** Është lulishtja në projekt.

**Qytetar:** Problem te Plazhi i Vjetër, pishat dhe pylli. Do ekzistojë më? Kanë rënë në shesh të gjitha. Cadrat janë ngulur në det. Buxheti nuk del. Shfrytëzohen asetet për tu pasuruar disa persona. Asetet e bashkisë, kioskë dhe 1 tavolinë me 150 cadra në ditë. Janë aktivitete të paligjshme që zënë hapsirën publike dhe bëhen milionerë. Ti mbajë çadrat bashkia, të punësoj dhe ti vë paratë në shërbim. Kanalet e rrugës hedhin rërë dhe cakëll.

**Ermal Dredha:** Kompania deri në dhjetor do bëj test dhe do ta asfaltoj. Pajë u miratuan projektet për Lungomaren drejt Plazhit të Vjetër. Qeveria miratoi buxhetin /FSHZH. Pyjet, projekt i miratuar, studim, menaxhim dhe mbarështrimin e pyjeve është në fazë tenderimi. Buxheti vjet ka patur shumë procedura tenderimi duan kohë, por do hidhen në sistem në tetor, do sistemohet pylli. Plazhet problem, para 2 javësh mbledhje për menaxhimin e plazheve, ka vite ky problem. Propozimi si para viteve 90. Ishte 5 lekë çadra. Të paguhet më pak dhe të shkojë për mirëmbajtje. Ju premtoj që do i shikoj me vëmendje, raporti 30-70 publik privat. Nuk zbatohen gjërat sic e marrin kontratën. Do e shikojmë me VKM dhe VKB. S'do dalim mbi ligjin. Do presim përfundimin.

**Qytetar:** Plazhi i Vjetër, 4 muaj me problemin e plerave, kazanet dhe pjesa që i rrethon.

**Ermal Dredha:** Pse nuk janë vendosur? Në vazhdimësi gjobitni biznesin që ndot, të zgjidhni komunitetin. Llogariteni vet, 1000 vota të komunitetit me 1 votë të biznesit.

**Qytetar:** Tregu ka kaluar 3 herë në KB. Trotuari që është zënë është prona ime.

**Ermal Dredha:** Po ta kërkojmë ne pjesën tënde? Kemi projekt me Ministrinë e Bujqësisë, për të ngritur një treg standart, të bashkojmë hapsirën tënde me pjesën tonë?

**Qytetari:** Është hapsira ime.

**Ermal Dredha:** Kemi dhe ne një pjesë. Do ndërtohet pallat? Do ja jepja komunitetit po të isha si ty.

**Qytetar:** Treg poshtë dhe pallat lart. 2 kate treg. Shikoni trotuarin.

**Qytetar:** Duam rrugë sipas standarteve dhe parametrave jo vetëm dheun pa cakëll. Kanalet, kanali 1 m me 2 shira mbytet. Merrni masa pa filluar shirat, pastrojeni. Nuk e nxjerr ujin.

**Qytetar:** Lagja 1 Maj, problem ujësjellësi, kanalizimet për ujrën e zeza, s'ka ku shkarkon te ura. Era e keqe dhe mushkonjat. Është e pabanueshme. Marveshjet e qeverisë jo vetëm për Lungomaren edhe për kanalin e Dautës. Zona e përmbytur nga pislëku. U bënë dizinfektimet pjesë pjesë. Nuk i jep zgjidhje. U asfaltua rruga. Firmat po bëjnë punimet, të punojnë me standarte. Bolierët duhen hequr. Suksese në punën tuaj!

**Ermal Dredha:** Tani kanë korrigjuar, nuk kanë përfunduar. Problemet e ujit do i japin zgjidhje qytetit, do durojmë sa të mbyllet.

**Qytetar:** Faleminderit për takimin. Blejmë ujë nga Lajthiza, Tërbaci etj..Duke patur ujë që derdhet në Vlorë. Cfarë do sjellë projekti?

**Ermal Dredha:** Projekti do sjellë ujë 24 orë, ujë i pijshëm. Prisni sa të mbaroj. Do bëjmë ndërhyrje dhe do e përfundojmë. Ky është qëllimi.

**Qytetar:** Stola në lagje para pallatit.

**Qytetar:** Stacioni i trenit do shtrohet pjesa para?

**Ermal Dredha:** Po, ka projekt rikonstruksioni para stacionit të trenit.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

**Koordinatorë për njoftimin dhe konsultimin publik**

**Albana Naçi**

